



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:029489

Datë: 20.10.2022

Numri i dokumentit: 03552301

P.nr.468/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit H.S nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.1313-1/17 të datës 27.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.18.10.2022 në prezencë të Prokurorit të shtetit Ardian Emini , përfaqësuesit të dëmtuarës dhe të pandehurit, me dt.20.10.2022 mori, shpalli dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H.S nga fsh....- Kacanik, i lindur më dt... nga i ati R... dhe e ema Xh..., e gjinisë M..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 24.03.2017 në fsh. Bajnicë, Komuna Kacanik, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar ...-

it , në atë mënyrë që personat e autorizuar të ...-it gjatë kontrollit të njehsorit elektrik me numër 35024357, kanë konstatuar se i pandehuri është lidhur direkt pa njehsor në rrjetin elektrik, pasi që më parë njehsori i ishte shkyqur për shkak të borxhit, ndërsa i pandehuri ka furnizuar pajisjet elektrike shtëpiake me energji elektrike, kurse energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me të cilin rast, të dëmtuarës ... , i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 558.13 € .

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,3,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-së, dhe neni 359,360,361 dhe 365 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 250.00 €(dyqind e pesëdhjetë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, ne emër te paushallit gjyqesor, derisa per Fondin per kompensimin e viktimave te krimit shumën prej 30.00€, në afat te njëjtë me gjoben, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1313-1/17 të datës 27.07.2017, të pandehurin H.S nga fsh.Bajnicë -Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale Vjedhja e

shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-se , dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.18.07.2022 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga Prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 18.10.2022, prokurori I shtetit Ardian Emini , deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës së rikualifikuar ne shqyrtimin fillestar.

Perfaqësuesi I të dëmtuarës B. S., ne fjalën e tij deklaroi se, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesën pasurore juridike, në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë per veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza.

Prokurori I shtetit dhe perfaqësuesi i të dëmtuarës, në fjalën e tyre janë dakorduar me pranimin e fajesise nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 326 lidhur me nenin 248 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesisë, se pranimi i fajesise është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurori I shtetit ne fjalen e saj përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barrë sipas aktakuzës, dhe meqë një pranim I tillë ka mbështetje edhe në provat qe gjinden në shkresat e lëndës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'I shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

I pandehuri ne fjalen e tij përfundimtare deklaroi se, në pamundësi për t'a paguar një pjesë të borgjit që I kërkohet për kyqje të rregullt nga ..., ka bërë lidhje ilegale në rrjetin elektrik , për çka thot se e ndien veten keq për veprimin e tij, të cilin premtion se nuk do t'a përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një

dënim sa më I ulët që të jetë e mundur, dhe ate me punë në dobi të përgjithshme ose dënim me gjobë.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-se.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 te KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajesinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në senacën e parë të shqyrtimit gjyqesor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti se I njejtë bazuar në evidencën e gjykatës ka patur edhe tri raste tjera penale, prej se cilave edhe të natyrës së njejtë, për të cilat është shpallur fajtor dhe është gjykuar me aktgjykime të formë s se prerë.

Andaj gjykata, për këto arsye, te pandehurin H.S , I akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-se, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPPK-se.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, është marrë konfor nenit 39 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike u mor konfor nenit 463 te KPP-së .

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK
P. nr. 468/17 datë 20.10.2022

Procesmbajtësja,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.